



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 6/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me apelin e kandidatit i subjektit politik nga Partija Kosovskih Srba (PKS), Goran Milicevic, me seli në Leposaviq, të paraqitur kundër vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 717/2017 të datës 24.05.2017, për tërheqjen nga lista e kandidatit për deputet në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur me 26.05.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. **PRANOHET** apeli si i bazuar i kandidatit Goran Milicevic, nga Leposaviqi, lidhur me tërheqjen nga lista për kandidat për deputet nga Partija Kosovskih Srba (PKS).
- II. **ANULOHET** vendimi i Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), me nr. 717/2017 të dt. 24.05.2017, lidhur me certifikimit të kandidatit Goran Milicevic, nga Leposaviqi.

Arsyetim

Me datën 25.05.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Goran Milicevic, kandidat për deputet në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, nga subjekti politik Partija Kosovskih Srba (PKS), Leposaviq, në të cilën kërkon që të tërhiqet nga lista për deputet, pasi që ai për arsye personale nuk mund të jetë në listën për kandidat. Parashtruesi e ka njoftuar subjektin e tij politik PKS dhe se emri i tij në këtë listë është kundër vullnetit të tij. Po ashtu nëpërmjet të kësaj shkrese dëshmon se nuk ka pranuar vullnetarisht të jetë në këtë listë. Parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i që ti merret për bazë kërkesa për tërheqjen nga lista e kandidatëve dhe të anulohet vendimi i KQZ-së.

PZAP-i, pas pranimit të apelit në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoj KQZ-në me datën 25.05.2017, për apelin që është bërë ndaj vendimit të KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit të njëjtën ditë.

PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja brenda afatit të caktuar me të cilën theksohet se në bazë të nenit 28.1 të LPZ-së “Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ një njoftim me shkrim në të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje”, të përcaktuar sipas nenit 24.1 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme. Në bazë të numrit të protokollit nr. 717/2017 të datës 24.05.2017, të mbledhjes së KQZ-së, është caktuar që data e hedhjes së shortit të bëhet me datë 26.05.2017, ndërsa ankesa e parashtruar nga ana e ankuesit me datë 25.05.2017, dhe duke u bazuar në nenin 28.1 të LQP-së, ankuesi nuk mund të tërhiqet.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i gjeti se apeli është i bazuar:

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LQP konkretisht me nenin 28.1 të LQP-së, ku përcaktohet se: “subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së, për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit”, ku sipas kësaj dispozite apeli i parashtruar nga ana e kandidatit Goran Milicevic është paraqitur brenda afatit kohorë dhe se ndryshimi i datës së hedhjes së shortit nga ana e KQZ-së, nuk mund të jetë në dëm të kandidatit.

Paneli konstaton se apeli është i bazuar pasi që neni 122.1 pika c, i LPZ-së, përcakton se: “nëse kandidati pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në procesin zgjedhor mund të parashtrorj apel në PZAP”. Andaj mbi këtë bazë paneli konstaton se apeli është i bazuar duke marrë parasysh faktin se kandidati për deputet Goran Milicevic, për arsye personale nuk dëshiron që të jetë pjesë në listat zgjedhore në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Andaj në bazë të nenit 122.1 pika c, dhe nenit 118.1, të LPZ-së, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 6/2017 më datën 26.05.2015



**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LQP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*